

QERSHOR 2022 | Nr. 17

# BULETINI MUJOR

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

[www.ild.al](http://www.ild.al) | [info@ild.al](mailto:info@ild.al)



Inspektori i Lartë i  
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani  
@ILD\_Albania

KONFERENCË NDËRKOMBËTARE E SHËRBIMEVE TË INSPEKTIMIT TË DREJTËSISË  
TIRANË 2022





## KONFERENCA

Drejtues dhe përfaqësues të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë nga vendet e Bashkimit Evropian u mbledhën në Tiranë më 24 dhe 25 Qershor 2022, me ftesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Artur Metani për të diskutuar mbi temën “Interesi i publikut në administrimin e drejtësisë dhe pavarësia e magjistratëve”. Magjistratë të Shërbimeve të Inspektimit të Belgjikës, Bullgarisë, Francës, Greqisë, Italisë, Portugalisë, Rumanisë, Spanjës dhe Shqipërisë diskutuan mbi temën “Interesi i publikut në administrimin e drejtësisë dhe pavarësia e magjistratëve”, në tre sesione pune me prezantime dhe diskutime në Pallatin Presidential në Tiranë. Kjo konferencë

ndërkombëtare u organizua nga Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Drejtësisë (RESIJ) dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bashkëpunim me CEPEJ (Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri, SEJ III), e me mbështetjen e programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Instrumenti horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022”. Konferenca ishte pjesë e aktiviteteve të RESIJ, ku përfaqësuesit e shërbimeve të inspektimit, anëtarë të RESIJ, në varësi të formës së organizimit, funksionimit apo kompetencave, prezantuan dhe shkëmbyen eksperiencat, idetë dhe kërkimet e tyre, lidhur me tematikat të cilat u trajtuan në konferencë.

*Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ) është krijuar në vitin 2017 dhe ka në përbërje institucionet e inspektimit nga vende të Bashkimit Evropian, me mbështetjen e Komisionit Evropian, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka statusin e vëzhguesit prej dhjetorit 2021.*



## CILËSIA E DREJTËSISË DHE PAVARËSIA E MAGJISTRATËVE ËSHTË PRIORITET I TË GJITHA VENDEVE

Me iniciativë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Z. Artur Metani u mbajt në Pallatin Presidencial, Konferenca Ndërkombëtare me temë “Interesi i publikut në administrimin e drejtësisë dhe pavarësia e magjistratëve”. Pjesëmarrës ishin drejtues dhe përfaqësues të shërbimeve të inspektimit të drejtësisë nga vendet e Bashkimit Evropian, konkretisht të Belgjikës, Bullgarisë, Francës, Greqisë, Italisë, Portugalisë, Rumanisë, Spanjës dhe Shqipërisë.

Konferenca u organizua nga Rrjeti Evropian të Shërbimeve të Drejtësisë (RESIJ) dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bashkëpunim me CEPEJ (Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri, SEJ III), e me mbështetjen e programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Instrumenti horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022”.

Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ) është krijuar në vitin 2017 dhe ka në përbërje institucionet e inspektimit nga vende të Bashkimit Evropian, me mbështetjen e Komisionit Evropian, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka statusin e vëzhguesit prej dhjetorit 2021.

Konferenca u përshëndet nga kryetarja e Kuvendit Znj. Lindita Nikolla; i ngarkuari me punë, Delegacionit të BE-së, Z. Alexis Hupin; i ngarkuari me punë i ambasadës së SHBA-së, Z. Demian Smith, Zv. Drejtuesi i Zyrës së Këshillit të Evropës, Z. Olsi Dekovi, koordinatoreja e Rrjetit Evropian të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ), Znj. Delphine Agoguet dhe Sekretarja e CEPEJ (Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë), Znj. Muriel Decot.

Në fjalën e tij përshëndetëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani e vuri theksin tek nevoja për bashkëpunim mes





shërbimeve të inspektimit, për të marrë modelet më të mira të njëri-tjetrit, për të bashkërenduar metodat e kontrollit dhe të vlerësimit të institucioneve të drejtësisë në përputhje me vlerat e përbashkëta evropiane, pavarësisht diversitetit të kulturave politike, juridike, sociale apo ekonomike.

“Historia në Evropë dhe jashtë saj po tregon se pavarësia e magjistratëve nuk duhet marrë si e mirëqenë, por mbetet një çështje që i përket të gjitha vendeve. Ky është standard i një dimensionit të përbashkët të shoqërive tona. Ky është një standard

ndërkombëtar. Sot të gjitha vendet duhet të shtojnë përpjekjet për forcimin e kësaj pavarësie, por nga ana tjetër edhe rritjen e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së organeve të sistemit të drejtësisë. Të dyja nuk mund të ecin, përveç se bashkë. Sa më i përgjegjshëm një magjistrat, aq më i garantuar është qytetari për të drejtat e veta. Sa më i pavarur magjistrati, aq me demokratikisht ecën shoqëria. Të dyja këto standarde, cilësia e drejtësisë dhe pavarësia e magjistratëve janë prioritet i të gjitha vendeve.”, tha Z. Metani Kryetarja e Kuvendit Znj. Lindita Nikolla në fjalën e saj vlerësoi ndryshimin që ka



*“Historia në Evropë dhe jashtë saj po tregon se pavarësia e magjistratëve nuk duhet marrë si e mirëqenë, por mbetet një çështje që i përket të gjitha vendeve. Ky është standard i një dimensionit të përbashkët të shoqërive tona. Ky është një standard ndërkombëtar. Sot të gjitha vendet duhet të shtojnë përpjekjet për forcimin e kësaj pavarësie, por nga ana tjetër edhe rritjen e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së organeve të sistemit të drejtësisë. Të dyja nuk mund të ecin, përveç se bashkë. Sa më i përgjegjshëm një magjistrat, aq më i garantuar është qytetari për të drejtat e veta. Sa më i pavarur magjistrati, aq me demokratikisht ecën shoqëria. Të dyja këto standarde, cilësia e drejtësisë dhe pavarësia e magjistratëve janë prioritet i të gjitha vendeve.”, tha Z. Metani*



ndodhur prej miratimit të reformës në drejtësi. “Sot, pavarësia reale e gjyqtarëve dhe prokurorëve, po konsolidohet paralel me “varësinë” e tyre prej Republikës, Kushtetutës, ligjeve dhe interesit publik. Sistemi i drejtësisë kishte arritur në atë pikë sa nuk e fshihte varësinë e vet, në të dy aspektet, politike dhe financiare. Sot, fijet që e lidhnin sistemin me format korruptive të mësipërme, janë këputur e po këputen dita-ditës. Pushteti gjyqësor po ndërtohet, fuqizohet dhe afirmohet si një pushtet i pavarur. Miti tjetër, se sistemi nuk mund të vetëreformohet, gjithashtu po rrëzohet. Dhe në këtë aspekt ka meritën e vet edhe Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, njëri prej organeve të reja dhe më të rëndësishme të qeverisjes së sistemit.”

I ngarkuari me punë i Delegacionit të BE-së, Z. Alexis Hupin nënvizoi në fjalën e tij punën e madhe që është bërë me reformën në drejtësi, si një praktikë europiane por është praktikë e re për Shqipërinë që vjen së bashku me sfidat krahas rregullave, krahas clirimit nga ngarkesa e çështjeve të prapambetura, krahas komunikimit me publikun por gjithashtu edhe për rekrutimin e më shumë

inspektorëve në rastin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. “Megjithatë pas dy vitesh vlerësojmë se ju vërtetë keni përmbushur pritshmëritë edhe pse shumë punë mbetet për t’u bërë. Sic e tha znj.kryetare keni bërë një rrugë të gjatë por ndikimimet e papërshtatshme e ndërhyrjet në çështjet e gjyqësorit vazhdojnë. Marrin forma të ndryshme. Marrin edhe formën e sulmeve ndaj reformës në drejtësi si e tërë por ndonjëherë marrin edhe formën e sulmeve kundër gjyqtarëve e prokurorëve. Për rrjedhojë do doja të falenderoja Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për sjelljen shumë profesionale ndaj kësaj trysnie për ta mbajtur gjyqësorin llogaridhënës por edhe për të ruajtur, cka është shumë e rëndësishme pavarësinë e tij.”, tha Z. Hupin.

I ngarkuari me punë i ambasadës së SHBA-së, Z. Demian Smith vërejti në fjalën e tij se sot po shohim një epokë të re ku sistemi po fillon t’u shërbejë qytetarëve dhe jo vetëm politikanëve, personave me lidhje politike, të pasur apo të inkriminuar. “Shtetet e Bashkuara ju nxisin që të vazhdoni punën e mirë dhe punën e madhe, pavarësisht pengesave që hasni. Krahas partnerëve tanë të BE-së – dhe dua t’i bashkohem komenteve të kolegut tim të BE-së për partneritetin e ngushtë midis Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit European për reformën në drejtësi – ne mbështetëm fillimin e Reformës në Drejtësi në 2016-ën dhe kemi qenë aty në çdo hap të rrugës, përmes vetingut dhe krijimit të institucioneve e reja. Kemi nisur të shohim



ndikimin e një gjyqësori më të pastër dhe të prokurorëve dhe hetuesve të përkushtuar kundër korrupsionit. Varet nga vigjilenca dhe angazhimi i institucioneve si Inspektorati i Lartë i Drejtësisë për të ruajtur përparimin kundër korrupsionit dhe për të garantuar integritetin e sistemit gjyqësor. Sot, ju keni diskutime të rëndësishme me partnerët evropianë se çfarë po funksionon dhe çfarë mund të bëhet më mirë. Në fund, ndryshimi i vërtetë, domethënës, ju takon juve, palëve në sistemin e drejtësisë, që të përqafojnë reformën dhe t'a bëni sistemin funksional për çdo shqiptar.” tha mes të tjerash Z. Smith. Zv. Drejtuesi i Zyrës së Këshillit të Evropës, Z. Olsi Dekovi tha se “Pavarësia e gjyqësorit kërkon bashkëpunimin e institucioneve dhe

instrumentave ligjore të ndryshëm si edhe një kombinim kushtesh dhe masash që mund të jenë të ndryshme në vende të ndryshme ku secili gjen ekuilibrin e vet. Kam besim se konferenca e sotme do të ndihmojë në ndërtimin e një platforme për inspektorët gjyqësorë për të prezantuar, diskutuar dhe shkëmbyer përvojat, idetë dhe kërkimet e tyre, perfshi dhe sfidat e inspektimit gjyqësor.” Koordinatorja e Rrjetit Evropian të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ) inspektorja magjistrate znj. Delphine Agoguet falenderoi Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për organizimin e këtij takimi në Tiranë dhe tha se shërbimet e Inspektimit në Evropë mund të kenë organizime shumë të ndryshme varësie por objektivin e punës e kanë të njëjtë. « Një sistem drejtësie nuk mund të jetë efikas dhe i pavarur nëse nuk mund të mbështetet mbi një sistem inspektimi që zotëron të njëjtat cilësi. Në të gjitha vendet, të gjitha autoritetet e ngarkuara me kontrollin, e kanë këtë përgjegjësi të madhe të krijojnë dhe të rindërtojnë besimin e qytetarit në drejtësi. Kontributi në forcimin e ktyre autoriteteve dhe shërbimeve është një nga misionet kryesore që i ka vënë vetes Rrjeti Evropian i Inspektimeve të Drejtësisë.» Në fjalën e saj, Znj. Muriel Decot, Sekretare e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) u fokusua në rolin e rëndësishëm të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të



garantuar që gjyqtarët dhe prokurorët të respektojnë standardet më të larta profesionale dhe të japin drejtësi për të gjithë qytetarët. “Përfitoj nga rasti të ritheksoj angazhimin e CEPEJ-it për të vazhduar mbështetjen e reformave në drejtësi në Shqipëri dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si një institucion kyç i sistemit të drejtësisë shqiptare”, përfundoi Decot.

Në konferencë merrnin pjesë kryetarja e komisionit për Cështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, deputetja Klotilda Bushka; kryetarja e Këshillit të Lartë Gjqësor, Znj. Naureda Llagami; kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë Z. Alfred Balla; Prokurori i Përgjithshëm Z. Olsian Cela; kreu i Strukturës së Posacme kundër Korrupsionit e Krimit të Organizuar, Z. Arben Kraja; anëtarja e Gjykatës Kushtetuese Znj. Marsida Xhaferllari; anëtari i Gjykatës së Lartë, Z. Ilir Panda; këshilltari ligjor rezident për kundër terrorizmin pranë ambasadës së SHBA në Shqipëri, Z. Clay Stifler, anëtarët e komisionit të disiplinës, njëkohësisht anëtarë të Këshillit të Lartë Gjqësor, Znj. Marcela Shehu dhe Z. Ridvan Hado; anëtarët e komisionit të disiplinës, njëkohësisht anëtarë të Këshillit të Lartë të



Prokurorisë, Znj. Mirela Bogdani, Z. Sokol Stojani dhe Znj. Esmeralda Keshi; gjykatësja e Apelit Shkodër Znj. Valbona Vata; Rektori i Universitetit të Tiranës, Z. Artan Hoxha; zëvendës Prokurori i Përgjithshëm në Gjykatën e Kasacionit, Itali, Z. Gianluigi Pratola; Z. Giovanni Pasqua, drejtues i projektit italian që mbështet Shkollën e Magjistraturës në Shqipëri, inspektorët e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe anëtarë të kabinetit.

Konferenca zhvillohet me tre sesione pune, që moderohen nga magjistratë europianë e gjatë të cilave, shefat dhe përfaqësuesit e shërbimeve të inspektimeve të drejtësisë referojnë mbi një tematikë të caktuar, brenda temës së konferencës “Interesi i publikut në administrimin e drejtësisë dhe pavarësia e magjistratëve”.







## INTERESI I PUBLIKUT NË ADMINISTRIMIN E DREJTËSISË DHE PAVARËSIA E MAGJISTRATËVE

### FJALA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, Z. ARTUR METANI NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE

Mirëmëngjes dhe mirë se erdhët në Shqipëri të gjithë të ftuarit dhe mirë se erdhët të gjithë në këtë konferencë.

Sot, ndihem shumë i privilegjuar, që në cilësinë e vendit organizator të hap punimet e kësaj konference dhe shumë i vlerësuar nga të gjithë të pranishmit dhe kolegët e mi të shërbimeve të inspektimit evropian të drejtësisë, të cilët kanë siguruar pjesëmarrjen dhe janë pjesë e kësaj konference! Faleminderit të gjithëve!

Në të njëjtën kohë, sot ndihem besimplotë, që ndërmarrja e kësaj iniciative kaq ambicioze, ka vlerë për të gjithë ne dhe zhvillimi i saj ishte mëse i nevojshëm.

Ideja e zhvillimit të këtij aktiviteti lindi krejt natyrshëm, duke ndarë disa mendime me homologun tim rumun z. Lucian Netoroju, mbi disa çështje lidhur me administrimin e drejtësisë, pavarësinë e magjistratëve, si dhe rolin e shërbimeve të inspektimit në këtë proces.

Të dy ndamë të njëjtin qëndrim: pavarësisht dallimit dhe diversitetit të kulturave tona politike, juridike, sociale apo ekonomike, historia

në Evropë dhe jashtë saj po tregon se pavarësia e magjistratëve nuk duhet marrë si e mirëqenë, por mbetet një çështje që i përket të gjitha vendeve. Ky është standard i një dimensionit të përbashkët të shoqërive tona. Ky është një standard ndërkombëtar.

Sot të gjitha vendet duhet të shtojnë përpjekjet për forcimin e kësaj pavarësie, por nga ana tjetër edhe rritjen e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së organeve të sistemit të drejtësisë. Të dyja nuk mund të ecin, përveç se bashkë. Sa më i përgjegjshëm një magjistrat, aq më i garantuar është qytetari për të drejtat e veta. Sa më i pavarur magjistrati, aq me demokratikisht ecën shoqëria. Të dyja këto standarde, cilësia e drejtësisë dhe pavarësia e magjistratëve janë prioritet i të gjitha vendeve.

Në këtë kuadër, gjetja e balancës midis interesit publik për administrimin e drejtësisë nga një anë dhe pavarësisë së magjistratëve nga ana tjetër, mbetet një sfidë permanente sepse pavarësia e magjistratëve dhe përgjegjshmëria e tyre, janë vlera dinamike. Zhvillimet shoqërore sjellin



*“Të gjithë ne sot duhet të bashkëpunojmë. Të gjithë ne duhet të analizojmë, të marrim modelet më të mira të njëri-tjetrit, si dhe bashkërendojmë metodat e kontrollit dhe të vlerësimit të institucioneve të drejtësisë në përputhje me vlerat tona të përbashkëta evropiane, pavarësisht dallimeve tona politike, ligjore apo sociale.”*

padysim edhe transformime shoqërore dhe ekonomike dhe raporti pavarësi/përgjegjshmëri mbetet përherë sfidë profesionale dhe institucionale.

Me këtë mendim, ka nevojë që të gjithë ne të gjejmë rrugën e duhur për të bashkëpunuar dhe për të identifikuar mundësitë dhe metodat më të mira të komunikimit dhe shkëmbimit me njëri-tjetrin.

Kështu u konceptua kjo ide dhe dita-ditës me kontributin e RESIJ dhe CEPEJ, të cilët dua t'i falënderoj fort, sot kjo ambicie u bë realitet.

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj!

Drejtësia ka kontributin e vet në jetën dhe cilësinë e çdo shoqërie. Krijimi apo konsolidimi i shtetit të së drejtës nuk është një proces i lehtë. Në çdo vend ky është një proces dinamik dhe në evoluim të vazhdueshëm për gjetjen e mekanizmave të duhur, të cilat sigurojnë respektimin e një sërë standardesh apo vlerash për një sistem drejtësie efikas, të përgjegjshëm dhe të pavarur.

Shqipëria ka kryer një reformë të thellë ligjore dhe institucionale në sistemin e drejtësisë. Pikërisht për të gjetur këto mekanizma dhe për t'u përshtatur me stadin e zhvillimit të shoqërisë

së saj. Kjo reformë u mbështet fort në çdo kuptim nga partnerë të vyer si Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe tashmë sfida e zhvillimit të kësaj reforme është përgjegjësia e aktorëve të drejtësisë.

Në këtë kuadër, një konferencë si e sotmja në Tiranë me këtë tematikë të rëndësishme përtej diskutimeve me njëri-tjetrin, është një kontribut real për vizionin dhe punën e përditshme të institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, por besoj edhe për organet e tjera të sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

Respektimi i të drejtave të njeriut, demokracia dhe shteti i së drejtës përbëjnë një aset kryesor për Bashkimin Evropian dhe ruajtja apo sigurimi i tyre përbën një përgjegjësi të përbashkët për të gjitha institucionet e BE-së, si dhe shtetet anëtare të tij. Megjithatë qasja ndaj tyre, nuk duhet të shihet si kufi, pengesë apo kusht ndaj shteteve të tjera jo anëtare, por si një simbol, i cili na bashkon të gjithëve ne. Evropa para se të jetë një projekt politik është një sistem vlerash njerëzore. Pasi në fjalët e Jean Monnet, Bashkimi Evropian nuk ka për qëllim bashkimin e shteteve, por mbi të gjitha bashkimin e njerëzve të cilët besojnë dhe jetojnë në sistemin e vlerave evropiane.

*“Gjetja e balancës midis interesit publik për administrimin e drejtësisë nga një anë dhe pavarësisë së magistratëve nga ana tjetër, mbetet një sfidë permanente sepse pavarësia e magistratëve dhe përgjegjshmëria e tyre, janë vlera dinamike. Zhvillimet shoqërore sjellin padysim edhe transformime shoqërore dhe ekonomike dhe raporti pavarësi/përgjegjshmëri mbetet përherë sfidë profesionale dhe institucionale.”*

Në këtë kuadër, besoj se të gjithë ne sot duhet të bashkëpunojmë. Të gjithë ne duhet të analizojmë, të marrim modelet më të mira të njëri-tjetrit, si dhe bashkërendojmë metodat e kontrollit dhe të vlerësimit të institucioneve të drejtësisë në përputhje me vlerat tona të përbashkëta evropiane, pavarësisht dallimeve tona politike, ligjore apo sociale.

Shpresoj që ky organizim për herë të parë në Shqipëri sot, jo vetëm t'i arrijë këto qëllime, por edhe të jetë pikënisja e një tradite, e cila të vijojë më tej.

Duke ju falënderuar edhe një herë për vëmendjen dhe praninë tuaj në Tiranë, më lejoni t'i uroj konferencës suksese dhe punime të mbara!

*Video e plotë e Fjalës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mund t'a ndiqni duke klikuar mbi [link](#).*

## TRE SESIONET E PUNËS SË KONFERENCËS SI SHKËMBIM EKSPERIENCASH MES SHËRBIMEVE TË INSPEKTIMIT TË DREJTËSISË



Konferenca u zhvillua në tre sesione pune, secili i pasuar me pyetje e diskutime nga pjesëmarrësit. Në sesionin e parë me temë kompetencat, organizimi dhe funksionimi i Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë, një këndvështrim krahasues moderoi kryetari i Inspektoratit Gjyqësor, Rumani Lucian Netejoru. Vetë Z. Netejoru referoi mbi Inspektoratin Gjyqësor të Rumanisë, format e ndryshme të organizimit, funksionimit dhe marrëdhënia me institucionet e tjera.

“Zhvillimi i inspektimeve dhe procedimi disiplinor i magjistratëve me qëllim rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë në Greqi” ishte tema e referimit të Z. Nikolaos Pipiligkas,

Zëvendëskryetar i Gjykatës Supreme për çështjet civile dhe penale “Areios Pagos”, Greqi.

Në këtë sesion pati dy referime nga Inspektorati i Bullgarisë, konkretisht, “Kompetencat, organizimi dhe funksionimi i inspektorateve përgjegjëse në Bullgari për kontrollin e magjistratëve. Praktika e Inspektoratit bullgar lidhur me deklarinimin dhe kontrollin e interesave pasurore të magjistratëve si një garanci për pavarësinë dhe integritetin e tyre me qëllim rritjen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor.” nga Inspektorët pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor Bullgari, Znj. Maria Neykova dhe Z. Lyubomir Krumov.

“Inspektimi dhe kontrolli i punës së magjistratëve dhe gjykatave sipas legjislacionit italian. Roli dhe



veprimtaria e shërbimeve të inspektimit.” ishte referimi i përgatitur nga Kryetarja e Inspektoratit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë, Znj. Maria Rosaria Covelli, Itali Diskutime.



Sesioni i dytë me temë “Pavarësia dhe përgjegjshmëria e magjistratëve. Garancitë dhe procedimi disiplinor i magjistratëve.” U moderua



nga Z.Vincent Delbos, Gjyqtar, ish Kryetar i Inspektoratit të Përgjithshëm të Francës.

Darian Pavli, Gjyqtar pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut referoi online temën “E drejta e shprehjes së magjistratëve dhe kufizimi i saj sipas kërkesave të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (ECHR). Përgjegjësia disiplinore në këto raste.”

Inspektori Gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit, Portugali Z. Vitor Manuel Ribeiro, referoi me temën “Përgjegjësia disiplinore e magjistratëve në raport me pavarësinë e tyre”

Znj. Béatrice Del Volgo, Inspektore e Përgjithshme pranë Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë, Francë referoi mbi temën “Hetimi dhe procedimi disiplinor i magjistratëve në përputhje me kërkesat e një procesi të rregullt ligjor sipas kërkesave të nenit 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR).”

“Përgjegjësia disiplinore dhe kufijtë e kontrollit të punës së magjistratëve.” ishte tema e referimit të Znj. Emanuela Aliverti, Inspektore pranë Inspektoratit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë, Itali.

Po në këtë sesion Zëvendëskryetar i Bordit të Inspektimit të Drejtësisë për çështjet administrative, Greqi, Z. Michail Pikramenos referoi mbi “Shërbimi i inspektimit të drejtësisë, ndërmjet pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së magjistratëve”

Sesioni i tretë me temë “Roli i shërbimeve të inspektimit si garantues për mirëfunksionimin dhe pavarësinë e sistemit të drejtësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Metodrat dhe sfidat e së ardhmes”, u moderua nga Znj. Delphine Agouet, Magjistrate, Inspektorati i Përgjithshëm i Drejtësisë, njëkohësisht koordinatore e RESIJ, Francë.

“Zhvillimi i procedurave të kontrollit dhe inspektimit të sistemit të drejtësisë nëpërmjet aplikimit të teknologjive të reja.” ishte tema që u referua online nga Z. Amparo Camazon Linacero, Kryetare i Shërbimit të Inspektimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, Spanjë dhe Znj. Elena Burgos





Herrera, Inspektore Gjyqtare pranë Shërbimit të Inspektimit në Këshillin e Lartë Gjyqësor, Spanjë  
 Znj. Valérie Delfosse, Kryetare e Komisionit Frankofon përgjegjës për kontrollin e magistratëve pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Belgjikë referoi mbi temën “Roli i shërbimeve të inspektimit, si një garant i mirëfunksionimit dhe pavarësisë së sistemit të drejtësisë në përputhje me legjislacionin dhe praktikat më të mira evropiane.”  
 Sesioni I tretë u mbyll me referimin e Z. Vincent



Delbos, Gjyqtar, ish Kryetar i Inspektoratit të Përgjithshëm të Francës/Këshilli i Evropës “Kalimi nga organet inspektuese të bazuara në vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve (inspektime ndaj magistratëve) në shërbimet përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë dhe performancës së gjykatave (inspektimet e bazuara në gjykata). Disa mësimet nga projektet në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe më gjerë. Metodatat dhe sfidat e mundshme përpara për shërbimet e inspektimit gjyqësor.”

## KONKLUZIONET E KONFERENCËS NDËRKOMBËTARE TË SHËRBIMEVE TË INSPEKTIMIT TË DREJTËSISË TIRANË 2022



Faleminderit edhe një herë të gjithëve për angazhimin tuaj sot!  
 Agjenda ishte pak intensive, pasi çështjet e diskutuara ishin të shumta. Por ishte një debat i

nevojshëm dhe shumë frytdhënës për të gjithë ne.

Jam përpjekur të mbaj shënime, për aq sa munda, si dhe njëkohësisht jam përpjekur të sintetizoj disa ndjesi dhe mendime, lidhur më çështjet e trajtuara sot. Por ato janë të shumta dhe koha në dispozicion nuk na premtonte. Megjithatë do përpiqem të trajtoj disa prej tyre. Personalisht mendoj, por edhe për sa u parashtrua nga pjesëmarrësit në këtë tryezë vlen të theksohen disa momente:

### CILËSIA E DREJTËSISË

Cilësia e drejtësisë është një prioritet i të gjitha



vendeve. Ka probleme të cilat janë të njëjta për vendet e Bashkimit Evropian. Disa janë në bllok për të gjitha vendet e Këshillit të Evropës dhe të tjera janë specifike për secilin prej tyre.

Përmirësimi i cilësisë së drejtësisë është një proces dinamik dhe në evoluim të vazhdueshëm. Realizimi i këtij qëllimi kërkon një nevojë të vazhdueshme për t'iu përgjigjur sfidave për identifikimin e mekanizmave të rinj të mbrojtjes së tyre.

Veprimtaria e magistratëve, por edhe gjykatat,



prokuroritë apo institucionet e tjera të drejtësisë duhet t'i nënshtrohen kontrollit apo vlerësimit në aspekt të cilësisë dhe efikasitetit të veprimtarisë së tyre.

Koncepti i "cilësisë së drejtësisë" nuk përfshin vetëm cilësinë e vendimeve gjyqësore, të cilat përgjithësisht janë objekt kontrolli brenda vetë pushtetit gjyqësor, por përfshinë një sërë elementesh të cilat lidhen me mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë si qartësia e zhvillimit të



procedurave dhe vendimeve gjyqësore, aksesit i individëve të organet e sistemit të drejtësisë, infrastruktura, afatet apo mekanizmat e vënë në dispozicion të publikut.

Efikasiteti i punës së magistratëve nga njëra anë dhe i sistemeve të drejtësisë nga ana tjetër është kusht i domosdoshëm për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë individëve, për respektimin e kërkesave të një gjykimi të drejtë, për të pasur siguri juridike dhe për të garantuar besimin e



publikut në shtetin e së drejtës.

### BESIMI I PUBLIKUT

Niveli i besueshmërisë së qytetarëve në organet e drejtësisë është element mjaft i rëndësishëm për sistemin e drejtësisë. Në demokraci drejtësia jepet në emër të qytetarëve. Besimi i publikut është i domosdoshëm për sundimin e ligjit dhe ky legjitimitin kërkon angazhimin e të gjitha shoqërive për të ruajtur këtë besim.



Besimi i publikut dhe respekti për gjyqësorin janë garanci të demokracisë dhe stabilitetit në një shoqëri demokratike. Niveli i besueshmërisë së qytetarëve në organet e drejtësisë është element mjaft i rëndësishëm për sistemin e drejtësisë, pasi ai është një tregues i rëndësishëm për të vlerësuar se si funksionon sistemi i drejtësisë dhe sundimi i ligjit në një vend.

Në këtë kuadër, një magjistrat nuk duhet të jetë përgjegjës vetëm respektimin apo jo të normave ligjore, por edhe ndaj njerëzve, shoqërisë si dhe organeve të pushtetit shtetëror. Duke ndikuar kështu, në mënyrë të drejtpërdrejtë në perceptimin dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Megjithatë fitimi i besimit të publikut, nuk do të thotë që pushteti gjyqësor duhet të jetë në një trysni të vazhdueshme për të dhënë vendime të cilat duhet t'i pëlqejnë publikut, apo publiku duhet të pajtohet domosdoshmërisht me to. Madje gjykatat duhet të jenë të pavarura dhe nuk duhet të ndikohen nga perceptimi i publikut mbi një çështje të caktuar.

Një vendim gjyqësor mund të ngjall kundërshtim publik deri dhe zemërim apo ndjenjë proteste. Por në këtë rast rëndësi ka REAGIMI. Mënyra se si publiku reagon ndaj një vendimi gjyqësor, si dhe debati i krijuar shërben jo vetëm si frymëzim dhe si një ndihmesë për formimin e karakterit social dhe politik të shoqërisë një vendi, por edhe si tregues i nivelit të besimit të tij ndaj sistemit të drejtësisë.

Vendimet gjyqësore mund t'i nënshtrohen diskutimit dhe debatit publik, por janë gjithmonë të detyrueshme për zbatim. Forma më e lartë e besimit të publik në sistemin e drejtësisë është respekti dhe njohja e "legjitimitetit" të organeve të pushtetit gjyqësor. Kjo arrihet atëherë kur qytetarët e një vendi njohin, zbatojnë dhe respektojnë me devotshmëri vendimet e pushtetit gjyqësor, duke pranuar "legjitimitetin" e tij në çdo rast, pavarësisht nëse janë dakord me të.

Tashmë sfida e të gjithëve ne nuk është më koha për të fituar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, por ndërtimi i një sistemi drejtësie, i cili të respektohet nga ana e tij.

#### PAVARËSIA E MAGJISTRATËVE

Sistemi i drejtësisë krahas veçorive dhe specifikave të cilat mund të ketë në vende të ndryshme, ai karakterizohet nga të njëjtat vlera, si dhe funksionon mbi të njëjtat standarde ndërkombëtare dhe parime të organizimit apo funksionimit të tij.

Parimet themelore të aplikuara për organizimin e pushtetit gjyqësor mbështeten në parimin universal të pavarësisë gjyqësore. Gjyqësori i pavarur dhe i paanshëm është institucioni me vlerën më të lartë në çdo shoqëri dhe përbën një shtyllë të domosdoshme të demokracisë dhe sundimit të ligjit.

Pavarësia e pushtetit gjyqësor mund të shoqërohet me ndryshime strukturore, institucionale dhe ligjore, por ajo mund të ketë sukses vetëm kur shoqëria e një vendi të ketë besim në legjitimin e pushtetit gjyqësor dhe të tregojë një përkushtim real ndaj këtij standardi. Ekziston një prirje e rëndësishme për të siguruar pavarësinë e pushtetit gjyqësor me rrugë të garancive formale dhe procedurave fikse. Edhe pse është e rëndësishme të pranojnë që sistemet



gjyqësore në vende të ndryshme kanë pasur evoluim apo rrugëtime të ndryshme të konsolidimit të tyre. Megjithatë, është i diskutueshëm fakti nëse duhet të aplikohet një standard ndërkombëtar uniform.

### SISTEMI LLOGARIDHËNËS

Duhet pranuar se rritja e kompetencës dhe pavarësisë së magjistratëve duhet të shoqërohet me një sistem llogaridhënës

Kjo sepse pavarësia nuk është privilegj, por është përgjegjësi. Në rastin konkret duhet të eksitojë një proces i vazhdueshëm i balancimit të pavarësisë dhe llogaridhënies. Këto procese duhet të karakterizohen nga veprimi dhe kundër reagimi në të njëjtën kohë. Sa më shumë kompetenca të zotërojë pushteti gjyqësor, aq më të larta duhet të jenë kërkesat për llogaridhënie.

Funksioni i magjistratëve të pavarur dhe të ngarkuar me interpretimin dhe zbatimin e ligjit njihet në mënyrë universale si tipari themelor i shtetit demokratik modern, gur themeli i vetë shtetit të së drejtës, por ky pushtet nuk është absolut. Kjo pasi magjistratët janë përfaqësues të organeve publike dhe ato kanë vetëm atë pushtet çfarë u cakton rendi juridik.

Për këtë qëllim, është e nevojshme që organet e qeverisjes së gjyqësorit të kenë një qasje aktive ndaj sistemit llogaridhënës të magjistratëve duke aplikuar qasje të reja, të cilat konsistojnë në aplikimin në mënyrë të kombinuar e standardeve të përgjegjshmërisë dhe përgjegjësisë së tyre.

Sistemi llogaridhënës i magjistratëve nuk duhet të keqpërdoret nga ana e organeve të tjera të pushtetit me qëllim kontrollin dhe cenimin pavarësisë gjyqësore.

Sistemi llogaridhënës duhet të udhëhiqet pikësëpari nga nocioni i përgjegjshmërisë së magjistratëve, si një mekanizëm parandalues dhe që siguron ndërtimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm.

### SISTEMI I PËRGJEGJËSISË

Në rast se këto mjete nuk rezultojnë efektive, atëherë në raste përjashtimore, si dhe në varësi të rrethanave të caktuara mund të aplikohen masat mbi përgjegjësinë penale, civile apo disiplinore të tyre, si dhe gjithmonë në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, sipas kërkesave të nenit 6/1 të KEDNJ-së

Rrjedhoja më e rëndësishme e parimit të pavarësisë së magjistratëve është mos përgjegjësia për vendimet që japin sipas bindjes së tyre, mbështetur në ligj. Megjithatë, pasoja e pushtetit dhe besimi që shoqëria i jep magjistratëve është e tillë që duhet të ketë disa mënyra për t'i mbajtur përgjegjës, përfshi edhe largimin nga detyra, në rast të shkeljeve që justifikojnë këtë veprim.

### ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SHËRBIMEVE TË INSPEKTIMIT

Legjislacionet kombëtare të vendeve të ndryshme ofrojnë modele të ndryshme të organizimit, funksionimit, apo raporte që organet inspektimit të sistemit të drejtësisë kanë me institucionet e tjera.

Çdo model i përzgjedhur duhet kuptuar si rezultat i zhvillimeve historike, traditës ligjore dhe kushtetuese, apo asaj politike dhe sociale të secilit vend. Këta faktorë diktojnë dhe rezultatin e arritur.

Ndërsa ushtrimi i të drejtës së ankimit dhe kontrolli nga një gjykatë më e lartë dhe brenda vetë pushtetit gjyqësor është mekanizmi i zbatuar tradicionalisht nga sistemet e drejtësisë për të garantuar kontrollin, cilësinë e një procesi gjyqësor, apo bazueshmërinë e së drejtës, sot ky mekanizëm po plotësohet me forma të tjera të jashtme kontrolli për të matur apo mbikëqyrur cilësinë e drejtësisë në kuadër të zhvillimit në mënyrën e duhur të proceseve gjyqësore dhe



menaxhimin efektiv të organeve të sistemit të drejtësisë.

Ky mision i rëndësishëm, lidhur me garantimin e këtyre standardeve i është besuar institucioneve tona, institucioneve të inspektimit.

Shërbimet e inspektimit duhet të përshtatin dhe të aplikojnë metodologji të posaçme kontrolli, si dhe ky proces duhet të realizohet gradualisht dhe mbështetur në një sërë kriteresh, standarde dhe garanci të mirëpërcaktuara.

Rregullat lidhur me organizimin dhe funksionimin e tyre duhet të përcaktohen qartë dhe në mënyrë shteruese në aktet më të lartë hierarkike legjislative si Kushtetuta apo të paktën në legjislacionin parësor të secilit vend. Kjo shërben si një garanci dhe stabilitet për veprimtarinë e tyre.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm lidhur me organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të inspektimit është garantimi i pavarësisë dhe paanshmërisë së veprimtarisë së tij. Shërbimi i inspektimit duhet të jetë i pavarur nga ekzekutivi dhe legjislativi dhe nga organi që vendos për vendosjen e sanksioneve disiplinore. Kjo duhet të realizohet nëpërmjet aplikimit të politikave apo masave të cilat synojnë garantimin e pavarësisë substanciale, strukturore dhe financiare të këtyre organeve. Nga ana tjetër për të siguruar besueshmëri dhe legjitimitet duhet që rekrutimi apo përzgjedhja e punonjësve të kryhet në bazë të meritave.



### BASHKËPUNIMI NDËRMJET INSPEKTORIEVE

Për të arritur këto të gjithë ne duhet të bashkëpunojmë. Të gjithë ne duhet të analizojmë dhe bashkërendojmë metodat e kontrollit dhe të vlerësimin të institucioneve të drejtësisë.

Kjo duhet të realizohet nëpërmjet takimeve periodike; shkëmbimit të eksperiencave; unifikimit të metodave dhe praktikave më të mira në përputhje me standardet e demokracisë dhe shtetit të së drejtës; krijimit të mekanizmave juridik, administrativ apo dhe praktik të bashkëpunimit; shkëmbimit të të dhënave; apo dhe ndihmës juridike të ndërsjelltë ndërmjet shteteve.

Në të njëjtën kohë, ky proces duhet të realizohet duke mbajtur në konsideratë zbatimin e standardeve të Bashkimit Evropian të transpozuar në legjislacionet kombëtare; parimet, frymën dhe jurisprudencën Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, apo Gjykatës Evropiane të Drejtësisë; aktet e Këshillit të Evropës; si dhe në aplikim të metodave, instrumenteve dhe praktikave më të mira të Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), për rritjen e cilësisë dhe efijencës së sistemit gjyqësor.

Duke vepruar kështu, të gjithë ne do të kontribuojmë në funksionimin e duhur të organeve të sistemit të drejtësisë dhe në përmirësimin e cilësisë së sistemit të drejtësisë,

duke arritur qëllimin tonë të përbashkët. Këto janë disa nga mendimet e mia lidhur me aktivitetin e sotëm.

Megjithatë nuk doja të përfundoja këtë fjalë pa shprehur disa mirënjohje dhe falënderime.

Faleminderit Këshillit të Evropës; Faleminderit CEPEJ, faleminderit Roland, Muriel dhe Olsi për kontributin e vazhdueshëm që jep duke ngritur kapacitetet e vendeve anëtare mbi organizmin dhe funksionimin e sistemeve gjyqësore, duke elaboruar vazhdimisht instrumente dhe mekanizma ligjore ndërkombëtare lidhur me efikasitetin, cilësinë apo vlerësimin e sistemeve të drejtësisë. Në të njëjtën kohë, krahas mbështetjes teknike, pa mbështetjen financiare të KE, këto aktivitete nuk do të ishin bërë të mundura. Faleminderit për mbështetjen dhe profesionalizmin e treguar.

Në këtë rast gjithashtu dua të shpreh mirënjohjen edhe për RESIJ, faleminderit Delphine, Lucian dhe kolegëve të tjerë. RESIJ na solli të gjithë ne bashkë sot këtu. ILD është pjesëmarrësi më i ri në RESIJ, por gjatë kësaj kohe të shkurtër kam pasur një bashkëpunim intensiv dhe shumë të dobishëm me këtë Rrjet. Organizimi i sotëm, është një tregues i qartë që Rrjeti funksionon dhe sjell rezultate konkrete dhe produkt në punën e tij. Për këtë arsye, ne duhet të tregojmë besim dhe duhet të kemi vullnetin e mirë t'a çojmë përpara këtë iniciativë.

Faleminderit të gjithë drejtuesve dhe përfaqësuesve të shërbimit të inspektimit, përfaqësuesve të institucioneve të drejtësisë, si dhe të gjithë pjesëmarrësit në këtë konferencë, të cilët ndan me shumë profesionalizëm eksperiencat e vendeve të tyre, modelet e organizmit dhe funksionimit të shërbimeve të inspektimit, standardet apo metodat më mira të cilat të gjithë ne duhet të ndjekim.

Dhe në fund një falënderim të veçantë për stafin

e zyrës së ILD dhe bashkëpunëtorët e mi, Linda, Dëshira, Moza, Klodi, Adela e të gjithë stafit, që kanë punuar shumë, deri në orët e vona për këtë aktivitet. Ju shpreh mirënjohje për impenjimin tuaj, angazhimin, si dhe mbështetjen që më keni dhënë për të ndërmarrë përsipër këtë iniciativë.

Të nderuar pjesëmarrës!

Kur po konceptoja bashkë me kolegët e mi ndërmarrjen e kësaj konference kishim disa dilema të mëdha. Cila do të ishte tema e kësaj konference?! Cilat do të ishin çështjet e përbashkëta që na bashkojnë të gjithëve ne?! Cilat janë dallimet?! Apo mbase për sa theksova edhe fjalën time përshëndetëse diversiteti jonë politik, juridik apo social, krijon në distancë dhe ndasi shumë të madhe ndërmjet nesh, e cila nuk mund afrohet, apo nuk mund të na sjellë të gjithëve bashkë për të ndarë me njërin-tjetrin ide, problematika të njëjta, apo rrugët e duhura për zgjidhjen e tyre.

Por jo, ky aktivitet tregoi të kundërtën! Tani mund të them me gjithë bindjen time se ky organizim ja vlejti dhe ka arritur qëllimin për të cilin u konceptua.

Kjo për faktin se në themel të saj qëndroi besimi jonë i përbashkët në vlerat evropiane si demokracia dhe shteti i së drejtës, partneriteti, komunikimi i suksesshëm, si dhe vullneti i mirë për të kontribuar në zhvillimin e rolit të shërbimeve të inspektimit.

Tani që ky aktivitet është në fazën përmbyllëse të tij, them se kjo traditë duhet të vazhdojë dhe ky është vetëm fillimi i një procesi të gjatë bashkëpunimi dhe ndërveprimit ndërmjet nesh.

Faleminderit të gjithëve!



## SEKTORI I NDIHMËS JURIDIKE DHE ANKESAVE



*Gjatë asistimit të ankuesve*

Komunikimi me qytetarët është pjesë e punës së përditshme të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Sektori i ankesave në ILD është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut. Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku ndodhet ankesa e tyre.


Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues cdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të

Gjatë muajit *Qershor 2022*, Sektori i Ndihmës Juridike dhe Ankesave ka pritur 24 ankues, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe 18 telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.



shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

### TAKIME DHE TELEFONATA ME QYTETARËT



## KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT



Koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, sipas ligjit dhe komunikon me kërkuesin, sipas nevojës për trajtimin e kërkesës për informacion publik. Kërkesa për informacion depozitohen nga

qytetarët, personat juridikë, grupet e interesuara në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: [info@ild.al](mailto:info@ild.al), si dhe asaj të koordinorit për të drejtën e informimit [amanta.jasa@ild.al](mailto:amanta.jasa@ild.al).

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

## SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit Qershor, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **17 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuesit t'i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).

## ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankesë, i cili:

- ⇒ mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- ⇒ të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me

email në [info@ild.al](mailto:info@ild.al) ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.

⇒ mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD [www.ild.al](http://www.ild.al), në seksionin “Si pranohen ankesat”.

## STATISTIKA MUJORE

Gjatë muajit **Qershor** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **77 ankesa**, 75 nga të cilat janë paraqitur nga qytetarët, **1 ankesë** nga OSHC dhe 1 nga një institucion.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Qershor** 2022. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

*“Angazhimi kryesor i institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ushtrimi i funksioneve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë në mënyrë sa më të pavarur, të paanshme dhe me integritet nëpërmjet një sistemi përgjegjshmërie dhe llogaridhënie.”*

### ANKETA E ILD

Komunikimi me publikun në funksion të transparencës mbetet një prioritet i vazhdueshëm për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Për të rritur komunikimin me qytetarët, Zyra e ILD ka hartuar dhe publikuar në faqen e internetit një Anketë, përmes së cilës kërkohet mendim mbi punën e deritanishme të institucionit. Anketa mund të plotësohet online ose fizikisht pranë ILD-së.

### QERSHORI I ILD NË SHIFRA

109 vendime arkivimi nga 142 praktika të shqyrtuara:

- ◆ 86 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar;
- ◆ 15 vendime arkivimi pas verifikimit (ILD);
- ◆ 8 vendime arkivimi pas verifikimit nga dosje të mbartura nga KLD;
- ◆ 18 vendime verifikimi;

## INTERVISTË E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË ARTUR METANI DHËNË PËR EMISIONIN “BREAKING” NË TOP NEWS



*Gazetarja Elisa Gjerani: Do flasim për drejtësinë. Gjatë ditës së premte është mbajtur një konferencë ndërkombëtare me homologë të vendeve të BE-së, për të diskutuar për sistemin shqiptar të drejtësisë. Kam kënaqësinë të kemi në një lidhje në ‘Skype’, Zotin Metani, Inspektor i lartë i drejtësisë. Faleminderit Zoti Metani!*

*Inspektori i Lartë i Drejtësisë Z. Artur Metani: Faleminderit për ftesën.*

*Gazetarja: A ka ngjashmëri sistemi shqiptar i inspektimit të gjyqarëve e prokurorëve me atë të vendeve të BE? Cilat janë sfidat parë nga ky këndvështrim?*

*Inspektori i Lartë i Drejtësisë Z. Artur Metani: Konferenca që u organizua në Tiranë të premten, me Shërbimet e Inspektimit të Drejtësisë të vendeve të Bashkimit Evropian dhe Inspektorit shqiptar është në kuadër të aktiviteteve, që Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në Shqipëri, po organizon në raport me dimensionin ndërkombëtar të kësaj zyre. Që në momentin e krijimit të kësaj zyre, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka qenë në kontakt me Rrjetin Europian të Shërbimeve*

të Inspektimit (RESIJ) dhe tashmë që Inspektori shqiptar është pjesë e këtij rrjeti, në kuadër të këtij bashkëpunimi u organizua edhe kjo konferencë. Format e organizimit të Shërbimeve të Inspektimit në Evropë, janë të ndryshme. Do përmendja tre kryesore. Një është modeli shqiptar, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë është një organ i pavarur i zgjedhur nga Kuvendi, i pavarur nga Këshillat, i pavarur nga Ministri i Drejtësisë, apo nga institucione të tjera të drejtësisë. Ka sisteme siç i ka Italia apo Franca, në të cilat Inspektori apo Shërbimet e Inspektimit janë në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Ka edhe vende të tjera të cilat ofrojnë një panoramë tjetër të organizimit, siç është raporti apo varësia që ka Inspektori, apo shërbimi i inspektimit, pra është në varësi të Këshillit të Lartë Gjyqësor sipas rastit. Por format e organizimit për idenë e kësaj konference nuk është se ndryshonin shumë, por e rëndësishme ishte tematika apo parimet për të cilat u mbledhën të diskutonin Shërbimet e Inspektimit. Kjo sepse pavarësisht dallimeve që vendet kanë, sistemet kanë apo shërbimet e inspektimit kanë, problematikat mbeten të njëjta, edhe pavarësisht nivelit të adresimit të këtyre problematikave.

*Gazetarja: E qartë, nga ana tjetër tema e konferencës tuaj ishte për pavarësinë e gjyqarëve dhe prokurorëve. Por në vendin tonë jo pak herë ka pasur debate dhe pakënaqësi që kanë shoqëruar vendimet e dhëna nga Gjykatat apo Prokuroritë, çfarë mund të bëhet në lidhje me këtë? Çfarë ka bërë Institucioni juaj për mbarëvajtjen e të*



*gjithë kësaj?***Inspektori i Lartë i Drejtësisë Z. Artur Metani:**

Raporti midis interesit të publikut për administrimin e drejtësisë, pra mënyra se si e ushtrojnë detyrën gjyqtarët dhe prokurorët nga njëra anë dhe nga ana tjetër pavarësia e tyre, si një element i rëndësishëm për funksionimin demokratik të shoqërisë është një raport dhe një balancë që nuk është e lehtë për t'u gjetur, pasi është një raport apo një balancë prezente kudo. Sipas konkluzioneve të konferencës, ky është një dimension të cilin e prekin të gjitha vendet, pavarësisht nivelit, ndryshimit të sistemit demokratik, politik apo institucional të shërbimeve të inspektimit a të gjykatave dhe prokurorive. E rëndësishme është që shoqëritë duhet të gjejnë balancën e duhur midis dy interesave të rëndësishme për zhvillimin e shoqërisë. Shqipëria padyshim i ka më të mprehta këto probleme sepse e tillë është situata në të cilën gjendet Shqipëria, edhe pas miratimit të reformës në Shqipëri. Më e rëndësishmja është që nxehtësia e momentit, apo mprehtësia e problematikave me të cilat ne përballlemi sot, të mos na e heqë vëmendjen nga fokusi kryesor, që duhet të jetë gjetja e balancës së duhur, sepse gjetja e kësaj balance së duhur nuk është për të zgjidhur një situatë sot, është për të parë apo për të krijuar një platformë dhe vizion për funksionimin e institucioneve për vitet e ardhshme, për dekadat që vijnë, sepse një precedent i keq sot është një precedent që nuk mund të zhbëhet që nesër. Për këtë arsye edhe investimi apo nismat që merr Inspektori i lartë i Drejtësisë në kuadër të kompetencave që ai ka shihen në këtë prizëm dhe përpiqen, që të përfshijnë pikërisht këtë balancë demokratike, kushtetuese, që është e rëndësishme jo për Zyren e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që

është e rëndësishme jo për gjyqtarët, por është në fakt e shëndetshme për shoqërinë, për zhvillimin demokratik të shoqërisë.

**Gazetarja: Në fakt si institucion keni 2 vite e 4 muaj që monitoroni sjelljen e gjyqtarëve dhe prokurorëve në drejtim të zbatimit të normave etike dhe profesionale. Çfarë ndryshimi mendoni që keni sjellë në këto dy vite e gjysëm?**

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Z. Artur Metani:**

Kjo është një pyetje e rëndësishme dhe themelore, e nuk do të doja që të ishte Inspektori i Lartë i Drejtësisë, që t'i përgjigjej se çfarë është bërë mirë dhe çfarë është bërë keq, nga kjo zyrë. Këtë e vlerëson shoqëria, këtë e vlerësojnë institucionet përkatëse. E rëndësishme për mua apo do të doja që ky vlerësim të ishte i bazuar në indikatorë dhe në analiza konkrete profesionale dhe jo në perceptime. Kjo është shumë e rëndësishme, jo thjesht për vlerësimin e punës të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, por për vlerësimin e punës së çdo institucioni të dalë nga reforma në drejtësi sepse padyshim pritshmëritë ishin të mëdha, problematikave me të cilat po haset sistemi janë shumë të mëdha, institucionet po funksionojnë. Por se si po funksionojnë dhe si po ecin duhet të maten në bazë, jo të një perceptimi, jo të një vlerësimi të përgjithshëm, por në bazë të indikatorëve dhe treguesve profesionalë, shkencorë dhe analitikë. Ajo që është e rëndësishme për institucionin është që të punojmë. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që nga momenti i krijimit të tij është munduar që të prekë çdo dimension të fushës që ai mbulon, të ushtrojë çdo kompetencë që ai ka. Për të sjellë një shifër, vetëm vitin e kaluar Institucioni i Inspektorit të Lartë të drejtësisë, ka kryer 18 procedime disiplinore, disa me masa të rënda siç janë



shkarkimet, disa me masa më të lehta, pikërisht për të treguar, së pari gjyqtarëve dhe prokurorëve që sistemi po funksionon, që Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është aktive, është këtu dhe po monitoron në mënyrë kushtetuese punën e çdo gjyqtari dhe prokurori. Por gjithashtu për t'i treguar edhe qytetarëve edhe institucioneve që zyra po ashtu funksionon, dhe që çdo pretendim dhe çdo ankesë që qytetarët apo institucionet kanë ndaj sistemit gjyqësor, të adresohet në këtë institucion, se do të gjejnë përgjigje sipas atyre parashikimeve që janë në ligj. Për mua kjo është e rëndësishme që të krijojmë besimin që sistemi po funksionon, që sistemi duhet respektuar, që çdo ankesë duhet të vijë në këtë zyrë, për t'u trajtuar në mënyrë ligjore, siç e ka parashikuar ligji këtë gjë, dhe hap pas hapi sistemi do fillojë të rimarrë veten, nëse ne respektojmë sistemin që kemi ngritur, sistemin të cilin duam ta respektojmë, sistemin i cili në mënyrë absolute do na garantojë funksionim demokratik të institucioneve. Vetëm kështu mund të ecim përpara në mënyrë demokratike, duke respektuar sistemin, të cilin kemi ngritur dhe vlerat për të cilat u ngritën institucionet e reja.

**Gazetarja:** *Reforma në drejtësi në fakt u miratua dhe bashkë me të lindën një sërë pritshmëri jo vetëm nga publiku, por edhe nga institucione të tjera që menduan që do të gjenin drejtësi në bazë të kësaj reforme. A*

*mendoni ju se sot e ka përmbushur misionin për të cilën u krijua?*

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë Z. Artur Metani:** Është shpejt për ta dhënë këtë përgjigje, sepse minimalisht Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për shembull, ka vetëm dy vite që është krijuar, pra është shumë shpejt për të dhënë analiza të tilla. E para unë vlerësoj arkitekturën e re të sistemit të drejtësisë. Për mua është një arkitekturë shumë e mirë që funksionon, është një arkitekturë që ruan pikërisht atë që është e rëndësishme për institucionet, pra ndarja dhe balancimi i pushteteve. Sot nuk ka asnjë mundësi që institucionet e reja të drejtësisë të mbivendosen; sot nuk ka asnjë mundësi që institucionet e reja të drejtësisë të ndikojnë në mënyrë antikushtetuese mbi punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve; sot nuk ka asnjë mundësi që politika apo grupet e tjera të interesit, të ndikojnë, në kuptimin negativ të fjalës, në punën e institucioneve të drejtësisë dhe rrjedhimisht në punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Unë e vlerësoj këtë model që ne kemi zgjedhur. Padyshim është herët për të thënë që ky model është më i miri, është herët për të thënë që ky model funksionon tërësisht, është herët për të thënë nëse ky model duhet ndryshuar apo jo, sepse për të dhënë një vlerësim të tillë, e para çdo organ duhet të kalojë ciklin e vet sistematik. E dyta situata në Shqipëri, edhe për shkak të kësaj reforme është në një gjendje traumatike dhe kjo është një gjë që e pranojmë të tërë dhe sfida nuk është për të pranuar këtë gjë. Sfida është për të gjetur zgjidhje sa më shpejt, që t'i përgjigjen sa më shpejt pritshmërive të qytetarit. Këtë po përpiqen të bëjnë institucionet, së pari Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, por besoj edhe institucionet e tjera, që po japin rezultatet e veta. Efektet e këtyre rezultateve padyshim

nuk janë automatike dhe mekanike dhe ta japin një efekt për rritjen e pritshmërisë dhe besimit për 24 sekonda, apo për 24 orë. Kjo do kohën e vet të përballjes me këto vlera për të cilat u krijuan institucionet e drejtësisë dhe të cilat po japin. E rëndësishme është që institucionet po prodhojnë, po prodhojnë, po punojnë dhe po prodhojnë, pak më shumë, pak më pak, nuk ka rëndësi, rëndësi ka që sistemi po funksionon.

*Gazetarja: Së fundmi, keni ju një koment për hartën e re gjyqësore?*

*Inspektori i Lartë i Drejtësisë Z. Artur Metani:*

Zyra e Inspektorit të Lartë të drejtësisë, nuk ka qenë pjesë e diskutimeve për hartën e re gjyqësore, sepse ligji ka parashikuar organet që merren me ideimin, konceptimin dhe miratimin e kësaj harte, siç është Këshilli i Lartë Gjyqësor, pastaj Ministri i Drejtësisë, dhe më pas Këshilli i Ministrave. Kështu që nuk kam koment për këtë.

*Gazetarja: Faleminderit shumë Zoti Metani që ishit në Breaking.*

*Inspektori i Lartë i Drejtësisë Z. Artur Metani: Faleminderit Ju.*

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ARTUR METANI ZHVILLON VIZITË PUNE NË BULLGARI



Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi një vizitë zyrtare në Sofje, me ftesë të homologes Znj. Teodora Tochkova, Inspektor i Lartë i Inspektoratit të Këshillit të Lartë Gjyqësor të Republikës së Bullgarisë. Z. Metani shoqërohej gjatë vizitës nga inspektorë të ILD-së, anëtarë të kabinetit, ambasadorja e Republikës së Shqipërisë në Bullgari, Znj. Donika Hoxha dhe ekspertja ndërkombëtare Znj. Anita Mihailova.

Vizita u zhvillua në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit, e nënshkruar mes Inspektoriatit të Këshillit të Lartë Gjyqësor të Bullgarisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë shtatorin e vitit 2021, gjatë vizitës së homologëve bullgarë në Tiranë. Gjatë takimit të punës me homologen Tochkova, u diskutua mbi rëndësinë e shkëmbimit të eksperiencave më të mira në procesin e inspektimit dhe procedimit disiplinor



të magistratëve. Inspektori i Lartë i Drejtësisë Z. Metani nënvizoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi në zhvillimin e mëtejshëm të institucionit, në kuadër të përbushjes së kompetencave kushtetuese.

Znj. Tochkova dhe ekspertët e institucionit bënë një paraqitje të kompetencave e përbërjes së institucionit, duke u ndalur në procedurat e kryerjes së inspektimeve tematike dhe



inspektimeve të planifikuara, inspektimeve të integritetit dhe të pasurisë së magistratëve, inspektimeve në rast të pretendimeve për zvarritje të proceseve gjyqësore dhe inspektimeve mbi përdorimin e të dhenave personale. Delegacioni i ILD-së u njoh nga afër me punën e Zyrës së Regjistrimit të Ankesave dhe Sistemin Elektronik të Regjistrimit të Ankesave e shpërndarjes së tyre.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Z. Artur Metani dhe delegacioni që e shoqëron, ka zhvilluar takime në



Këshillin e Lartë Gjyqësor, me Z. Boyan Magdalinchev dhe anëtarët e Këshillit, me Kryetarin e Gjykatës së Lartë Administrative Z.



Georgi Cholakov; në Gjykatën e Lartë të Kasacionit, Zv. Kryetaret, gjykatësen Evgeni Staykov dhe gjykatësen Mimi Furnadjieva, si dhe gjykatësen Galina Toneva; me kryetarin e Gjykatës Kushtetuese Znj. Pavlina Panova dhe me kryetarin e Gjykatës Administrative të Veliko Tarnovo, Z. Georgi Chemshirov.

Gjatë takimeve u shkëmbyen pikëpamje mbi rëndësinë e shtetit të së drejtës në funksionimin e një shoqërie demokratike.



**QERSHOR 2022**

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë


© ILD

**KONTAKT ILD**

**WEB:** [ild.al](http://ild.al)

**EMAIL:** [info@ild.al](mailto:info@ild.al)

**ADRESA:** Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",  
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD  
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë  
[youtube.com](https://www.youtube.com)

*[Kliko](#) për të ndjekur spotin prezantues të ILD*